



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. Prot. _____

Tiranë, më __, __, 2017

Lënda: Njoftim mbi Vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave
“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”

**INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE NËN
PËRGJEGJËSINË E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

OPERATORËVE EKONOMIKË

Tiranë

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” ku ndër të tjera përcaktohet riorganizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera përdoruese të sistemeve, infrastrukturës, aplikacioneve dhe përfitues të pajisjeve TIK si dhe të shërbimeve të qendëruara për e-qeverisjen, në koordinimin dhe rregullimin e bazave të të dhënave shtetërore etj.

Nëpërmjet këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (në vijim AKSHI) do të jetë institucion i një natyre të veçantë si ofrues i drejtpërdrejtë shërbimesh për sektorin publik dhe privat nëpërmjet ofrimit të shërbimit të nënshkrimit elektronik. Akshi do të ketë në përgjegjësi ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve përfshirë edhe ato të klasifikuara si sekret shtetëror dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, **për institucionet dhe organet e administratës shtetërore sipas listës nr 2** bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe organizimin e prokurimeve të përqendruara për pajisjet TIK dhe për shërbimin e rrjeteve publike dhe private (internet dhe intranet) përfshirë edhe ato të klasifikuara si sekret shtetëror, për këto institucione.

Duke ju referuar kompetencave, detyrave dhe përgjegjësi, AKSHI do të ketë një rol qendror në zhvillimet e sistemeve TIK, dhe ndër më kryesoret janë përcaktimet e parashikuara në germet “gj”, “i” dhe “j” të pikës 5 të këtij vendimi:



- gj) *ngre, mirëmban dhe administron sistemeve dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK përfshirë edhe ato të klasifikuara si sekret shtetëror, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave;*
- i) *organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet softëare dhe hardëare, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi;*
- j) *organizon, kryen prokurimet e përqendruara dhe lidh kontratat për pajisjet TIK përfshirë edhe ato të klasifikuara si sekret shtetëror, për institucionet sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.*

Sa më sipër, i tërhiqet vëmendje të gjithë autoriteteve kontrakore pjesë e listës nr. 2 të këtij vendimi që për objektet pjesë fushës së zbatimit të kësaj VKM-je, për të cilat nuk është lidhur kontrata për vitin 2017, si dhe për nevojat për projektet dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për vitin 2018, të dërgojnë pranë AKSHI-it kërkesat e tyre brenda 1 jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Mirlinda KARÇANAJ